

**AKT THEMELIMI DHE STATUT  
PER  
SHOQERIN  
“GLOBAL CONSTRUCTION SOLUTIONS SH.P.K.  
(Shoqeri me Përgjegjesi te Kufizuar)**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe, ligjit nr.9723. date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit ” une i nënshkruari shpall si ë poshtë vijon:

**Neni 1  
FORMIMI I SHOQËRISË**

Formohet shoqëria e quajtur **GLOBAL CONSTRUCTION SOLUTIONS SH.P.K.** (Qe ketu e me poshte referuar si “Shoqëria”, e cila themelohet nga 2 Ortake ndare ne 2 kuota me nga nje kuote secili me % kontributi si me poshte :

**Z. Agim Tafa** I biri Zyberit , lindur me 28-02.-1951, në Fier dhe banues ne Tirane, ortake me nje kuote me 50 % te kontributeve baras me 25.000 leke

Mbajtës I kartes se identitetit me Nr.Personal F10228094R, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,


**Znj Sanije Tafa** , e bija e Fasllit , lindur ne Lushnje me 01-02.-1955 mbajtes I kartes se identitetit me Nr. personal F55201191Q madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ortake me nje kuote me 50 % te kontributeve baras me 25.000 leke

**Neni 2**

**QENDRA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Rr: “ Rruga e Kosovareve”, Pall. “Melroz 3”, Ap. 5/ Kati i pare , **Tirane, Shqiperi.**

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.



### Neni 3

## KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa afat duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Biznesit (QKB).  
Shoqëria mund të perfundojë, të vihet në likuidim përpara këtij afati ose mund të zgjase aktivitetin e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve .

### Neni 4

## OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti Kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Shiteblerje materiale ndertimi .Ndertim banesa Rruge Trajtimi i dyshemeve të betonit , shitje blerje dhe importe dhe eksporti i të gjitha materialeve të lidhura direkt ose indirekt me objektin kryesor gjithashtu dhe aktivitete të tjera si më poshtë ;

1. Importimin dhe eksportimin, prodhimin, perpunimin, transformimin dhe tregtimin e mallrave dhe paisjeve të ndryshme të konsumit, paisjeve elektronike, materialeve të ndertimit dhe mallrave ushqimore.
2. Shoqëria ka për objekt gjithashtu edhe ndertimin, dhe shit blerjen e e pasurive të paluajtshme duke u paisur me licensat e nevojshme për këto qëllim nga organet kompetente.
3. Shoqëria mund të blejë, të hyjë në marrëdhënie *leasing* dhe të marrë apo të japë me qira terrene, impiante dhe uzina, mund kryejë, përveç aktiviteteve tregtare edhe aktivitete si industriale ashtu edhe bujqësore.
4. Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditore si edhe të blejë apo shesë apo të marrë apo japë me qera pasuri, si edhe të ketë interesa apo pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë një objekt të ngjashëm apo funksional në arritjen e qëllimeve të Shoqërisë, si dhe të ofrojë garanci, të marrë hua dhe të ofrojë garanci, pasurore apo personale, në favor të të tjerëve. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj.
5. Shoqëria mund të kryejë tregjet materiale farmaceutike e tjera
6. Të kryejë shërbime VIP (Rruajtjes fizike me truporje dhe shërbime me



- mjete te blinduara ,transferime te vlerave monetare me automjete te blinduara )
7. Pritje Akomodim me te gjithë llogjistiken e nevojeshme per delegacione te huaja per te gjitha aktivitetet qe ata do te kryejne ne republiken e shqiperise .
  8. Dhenija me qera e automjeteve individeve ,shoqerive tregtare dhe institucioneve shteterore
  9. Blerje shitje makina te ndryshme perfshi ato te blindura
  - 10.–Blerja shitja e Medikamente dhe materialeve ndihmese per shendetesin kancelari e te tjera materiale per fusha te ndryshme
  - 11.Sherbimi i pastrimit te ambjente publike dhe private
  - 12.Shitje peme dekorative luleve dhe peme prodhuse frytore e te tjera

### Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakeve sipas legjislacionit ne fuqi


### Neni 6

## KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqerise është 50.000 (Pesedhjet mije) leke dhe i ndarë në 2 kuota nga nje secili me te njejten vlere . Kuotat jane ndare ne perqindje per ortakët si me poshte.

Kapitali zotërohet 1 (Nje) kuote 50% e kontributit nga ortaku i i shoqerise Z Agim Tafa e 1(Nje) kuote 50% nga Znj Sanije Tafa  
Ortakët mund te vendosin te rrisin kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te asamblese se ortakeve sa here qe shoqeria te kete nevojë per tu mbuluar financiarisht per zhvillimin normal te aktivitetit te saj kur ajo te kete te papaguar furnitore etj mungesa te likujditetit ose dhe me kontribut ne natyre

. Detyrimet e ortakeve kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre Ortaket nuk do te kene asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.



Shoqëria nuk pergjigjet per detyrime te marra nga administratori per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.

#### Neni 7

### REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit ne Qendren Kombetare t e Biznesit ( QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.-5-.2007.

#### Neni 8

### KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet :

- a) kontributit ne cash dhe ne natyre ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjesisht, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- Transferimi per cfaredo arsyeje, teresisht ose pjesisht i pjeseve te kapitalit te Shoqerise eshte subjekt i se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte ne raport me pjeset e tyre te kapitalit, brenda 30 (tridhete) ditesh nga marrja e njoftimit te derguar me leter rekomande. Ne kete njoftim duhet te saktosohet cmimi i kerkuar, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe i njejte me ate qe do ti ofrohet nje personi te trete, jashte shoqerise. Ne rast se ortaket e tjere nuk pergjigjen brenda afatit te parashikuar, konsiderohet se ata kane hequr dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes.



- Ne rast se njeri prej ortakeve refuzon ose heq dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes, ortaket e tjere, te cilet tashme kane ushtruar te drejten e tyre te parablerjes, mund ta riperdorin kete te drejte edhe per pjesen e ofruar ortakut qe e refuzoi ate.
- Ne rast se me shume se nje ortak deshiron te riperdore te drejten e parablerjes, pjeset e kapitalit te ofruara ortakut qe nuk deshiron te ushtronte te drejten e tij, ndahen proporcionalisht me pjeset e kapitalit respektiv.
- Ne rast se vetem njeri prej ortakeve deshiron ta ushtroje te drejten e parablerjes, pjesa e kapitalit te ofruar i transferohet atij teresisht ose ne ate mase qe ky ortak deshiron.
- Per kete qellim, ortaket qe deshirojne te riperdorin te drejten e tyre te parablerjes duhet te njoftojne vendimin e tyre ortakut qe deshiron te transferoje pjeset e tij te kapitalit brenda 15 (pesembedhete) ditesh qe prej marrjes se lajmit per mos ushtrimin e te drejtes se parablerjes prej ndonjerit prej ortakeve.
- Te gjitha njoftimet e siperpermendura do te behen me shkrim dhe i adresohen Administratorit te Shoqerise

### Neni 9

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

### Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori

### Neni 11





## KOMPETENCAT E ORTAKUEVE TE SHOQERISE

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Asambleja Ortakeve shprehet me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tij te pershkruara si me poshte:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut.
- Percakton politikat tregetare te shoqerise
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Ai emeron ose shkarkon administratoret, likujduesit ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikeqyr zbatimin e politikave tregetare nga administratoret ,perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miraton zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miraton pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- I jep autorizimin Administratorit ta perfaqesoj shoqerine ne gjykate Kryen riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miraton rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Miraton lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise ne perputhje me kriteret qe i jep ligji per shoqerit tregetare etj.
- Merr vendime te tjera ne dobi te veprimtarise tregetare

### Neni 12

Marrja e vendimeve te Ortakeve regjistrohet ne regjistrin e vendimeve te ortakeve ,mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.





## Neni 13

### THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe shte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga Adminsitratoret ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5 % te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise .

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese .Njoftimi ne te dyja formate e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten ,oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

## neni 14

### PJESEMARRJA NE VENDIME

Cdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50% te kuotave, dhe votojne pro tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres personalisht, ose qe votojne me shkrese apo me mjete elektronike.



## Neni 15

### ADMINISTRIMI

Shoqeria administrhet nga nje administrator i cili caktohet ne statutin e shoqerise nga Asambleja e Ortakeve ne rast se shoqeria do te kete me shume se nje ortak. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe jo me te gjate se 5 vjet me te drejte ripertesitje kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, asambleja e ortakeve vendos shkarkimin e tij per shkaqe te arsyeshme.

Administratori detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise ,bilancin e konsoliduar dhe raportin e e curise se veprimtarise, dhe se bashku me me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise u'a jep shprehimisht Asamblese se ortakeve .

Administratori ka te drejte te nenshkruajne per, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, cdo lloj operacioni bankar, te veproje me cdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj, .

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa dhe detyrime per tu paguar ose veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare dhe terheqje parash qe do te ndermerren nga Administratori per llogari te shoqerise, eshte e nevojshme dhe e detyrueshme nenshkrimi i Administratorit se bashku me vulen e shoqerise, ne menyre qe keto veprime te jene te detyrueshme per shoqerine.

**Administratori nuk mund te kryeje pa miratimin e Asamblese se Pergjithshme:**





- Lenien peng ose ne hipoteke te pasurive te shoqerise;
- Shit-blerje te pasurive te paluajteshme ne pronesi te Shoqerise;
- Te kontraktoje ne cfaredo lloj forme qofte, te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin ne emer te saj per paradhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve

Administratori i vetem i shoqerise eshte **Z.Eriol Tafa** shqiptare me nr personal I70406006N madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai do ta ushtroje kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

#### Neni 16

### MARREDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### Neni 17


### KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

#### Neni 18

### EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet nga asambleja e ortakeve .Ortaku cakton dhe shperblimin perkates midis tyre si marrdhenie dy paleshe




## Neni 19

### VITI FINANCIAR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat lidhur me perlllogaritjen e rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të ceshtjeve të mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, mbasi eksperti kontabel ti ketë certifikuar ato si të verteta dhe të sinqerta atehere asambleja vendos se çfare do të bëj me fitimin apo humbjen e shoqërisë nëse do të ndahen si dividend apo do të shtoj kapitalin e saj.

## Neni 20

### SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Në rast se shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye Ortaket vetëm përcaktojnë mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

## NENI 21

### ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti do të zgjidhen me mirkuptim dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis palëve të interesuar.

Në rast se nuk do të arrihet një zgjidhje me mirkuptim të mosmarrëveshjes, ajo do të besohet Gjykatës së Rrethit Tiranë.




Neni 22

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit ".Cdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie. per cdo gje qe nuk eshte shprehur ne statut merret ne konsiderat ligji dhe aktet nen ligjore ne fuqi Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

**ORTAKET E SHOQERISE**

Z. Agim Tafa



Znj Sanije Tafa



Dt. 28/05/2020